



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:009248

Datë: 02.11.2018

Numri i dokumentit: 00160333

**P. nr.252/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.G. nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.319/18 të datës 27.03.2018 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **30.10.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala dhe të akuzuarit F.G., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **F. G.** nga Gj., Rr”A.I. “ nr. ... lagjja K.i,i biri i R. dhe i nënës S. e gjinisë K., data e lindjes..., analfabet, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar.

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:**

**-me dt. 26.01.2018, rreth orës 08.00 min**, në Gjakovë, pikërisht në rrugën “A. I.”, me qëllim përvetësimi të kundërligjshëm për vete apo personit tjetër, në atë mënyrë që me datën e lartcekur i pandehuri F., përderisa ishte duke mbledhur shishe të plastikes ka vërejtur një kapak të pesetës (kanalizimit), të cilën e merr e copëton në grimca të vogla dhe e tjetëron, me ç’rast të dëmtuarit i sjellë dëm në vlerë rreth 70 euro.

**-me çka ka kryer veprë penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,43,49,50,51,52.5,73 të KPRK-ës, dhe nenit 325/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit F. G. i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve** si dhe dënim me gjobë ne shume prej **100 (njeqind )euro** ,te cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari P.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20.00 €. në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.319/18 të datës 27.03.2018 , e ka akuzuar të akuzuarin F.G. nga Gj. , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325/2 të KPRK-së,

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 30.10.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Ramiz Buzhala , pasi lexon aktakuzën, deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari F.G. , në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tersi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer për shkak te kushteve ekonomike me qene se jam i papunë dhe kam vepruar ne atë mënyrë me qellim qe pas gjetjes se te njëjtës shaktë e cila ka qene edhe e dëmtuar te siguroj gjera ushqimore për familjen me qene se te gjithë jemi te pa punë dhe te ardhurat i realizojë duke mbledhur kanaqe dhe shishe ne rrugë ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshme, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm dhe nuk do te përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme , gjendjen e dobët ekonomike , si dhe faktin se me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari F.G. : **me dt. 26.01.2018,rreth orës 08.00 min**, në Gjakovë, pikërisht ne rrugën “A.I.”, me qëllim përvetësimi të kundërligjshëm për vete apo personit tjetër , ne atë mënyrë qe me datën e lartcekur i pandehuri F. , përderisa ishte duke mbledhur shishe te plastikes ka vërejtur një kapak te pesetës (kanalizimit), të cilën e merr e copëton në grimca te vogla dhe e tjetërson ,me ç ‘rast te dëmtuarit i sjellë dem në vlerë rreth 70 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i

përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari ne çdo fazë te procedurës , gjendjen e dobët ekonomike, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , kërkim falja nga i dëmtuari , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla , si dhe fakti i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3(tre)**muajve si dhe dënim me gjobë ne shume prej **100 (njëqind )euro** ,te cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u muarr konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.252/18 më datë 30.10.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.